

Arsyetim për rritjen e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në 1,00%

(“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 145/ 23)

Në pajtim në vlerësimin e rregullt tremujor të rreziqeve sistemike, i cili përfshin të dhënat për tremujorin e tretë të vitit 2023, duke përfshirë treguesit më të rinj, Këshilli i Bankës Popullore miratoi vendim për **rritjen e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut për 0,25 pikë përqindje, nga 0,75% e përcaktuar më parë në 1,00%, e zbatueshme me zbatim nga 1 korriku 2024.** Normat e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave ndaj klientëve të vendeve të tjera do të zbatohen në pajtim me lartësinë e normës së përcaktuar nga autoriteti kompetent i vendit tjetër. Bankat janë të detyruara t'i përfshijnë këto norma në llogaritjet për përcaktimin e normës së përgjithshme (ose të a.q. normë specifike) të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për tremujorin e tretë të vitit 2024. Ndryshe, në pajtim me vendimet e mëparshme të Këshillit të Bankës Popullore, nga 1 gushti 2023 deri më 31 dhjetor 2023, në llogaritjet për përcaktimin e shkallës specifike të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, shkalla e shtresës mbrojtëse kundërciklike për ekspozimet ndaj klientëve nga Republika e Maqedonisë së Veriut është 0,5%, ndërsa nga 1 janari 2024 deri më 30 qershor 2024 kjo normë është 0,75%.

Vendimi për rritjen e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave bazohen në vlerësimet e rritjes së mëtejshme graduale të rreziqeve sistemike ciklike dhe periudhën e pasigurisë së zgjatur nga zbatimi i tyre. Në kushtet e sistemit bankar të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm me rritje të përfitueshmërisë dhe nivel të përshtatshëm likuiditeti, kur rreziqet nuk kanë ende ndikim në bilancet e bankave vendase, **rritja e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit synon të veprojë në mënyrë parandaluese drejt forcimit të mëtejshëm të rezistencës së bankave dhe në këtë mënyrë të sigurojë stabilitet më të lartë financiar.** Rritja e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit është edhe në pajtueshmëri me masat e marra në një numër më të madh vendesh të Bashkimit Europian, të cilat kërkojnë mjaftueshmëri më të madhe të kapitalit të bankave si mbrojtje ndaj rreziqeve të mundshme nga mjedisi.

Rritja e shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit bazohet në të dhënat shtesë për rrezikun sistematik, veçanërisht ato që lidhen me tendencat makroekonomike dhe tregun e pasurive të paluajtshme dhe që mund të nxisin në mënyrë indirekte natyrën ciklike të rrezikut të kredisë. Prandaj, theksohet veçanërisht ndikimi i ritmeve të larta të ndryshimit në nivelin e përgjithshëm të çmimeve, si dhe i ritmeve të larta të çmimeve të pasurive të paluajtshme në kushtet e rritjes së vazhdueshme të ndjeshme të kredisë për banesa. Rritja e vazhdueshme dyshifrore e nivelit të përgjithshëm të çmimeve në baza vjetore (16,1% në tremujorin e parë të vitit 2023) ka shkaktuar shtrëngim të kushteve financiare nëpërmjet rritjes së normave të interesit dhe shtrëngimit të kushteve të kreditimit, gjë që paraqet faktor rreziku të rëndësishëm për aftësinë kreditore të klientëve të bankave. Norma vjetore e rritjes së çmimeve të pasurive të paluajtshme

ka qenë dyshifrore për gjashtë tremujorë radhazi, dhe megjithëse është ngadalësuar disi, mbetet në nivele të larta (18,8% në tremujorin e parë të 2023 dhe 20,1% në tremujorin e katërt të vitit 2022). Ngadalësimi i rritjes së çmimeve të banesave vjen pas rritjes prej 21,2% që u arrit në tremujorin e tretë të 2022 dhe që është historikisht rritja më e lartë vjetore që nga kriza globale ekonomike dhe financiare. Rritja e çmimeve të banesave është ende e lartë dhe tejkalon prirjen e saj afatgjatë, gjë që tregon nevojën për mbikëqyrje të kujdesshme të këtyre prirjeve edhe në periudhën e ardhshme. Prandaj, është ende herët për të vlerësuar natyrën e këtyre ndryshimeve. Edhe kredia për banesa, pavarësisht ngadalësimit, vijon të rritet me ritme dyshifrore (11,4% më 31.3.2023 dhe 12,8% më 31.12.2022). Portofoli i kredisë për banesa është i shëndetshëm dhe i cilësisë më të lartë dhe përtani nuk ka shenja të realizimit të rrezikut të kredisë, por mjedisi i pasigurt makroekonomik theksojn rreziqet për periudhën e ardhshme dhe tregon nevojën për vigjilencë më të madhe nga bankat dhe kujdes në zbatimin e masave makroprudenciale për forcimin e mëtejshëm të rezistencës së bankave.

Sistemi bankar është i shëndetshëm dhe i qëndrueshëm në kushtet e rënies së kredive me probleme, rritjes së përfitimit dhe aftësisë paguese, si dhe ruajtja e nivelit të mjaftueshëm likuiditeti, gjë që konfirmohet edhe nga gjetjet e testeve të rregullta të stresit, kryesisht për rezistencën e lartë të bankave vendase ndaj goditjeve të mundshme. Në tremujorin e parë të vitit 2023, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit u rrit në 18,0%, u rrit profitabiliteti i sistemit bankar, dhe portofoli i kredisë është cilësor, me normën e kredive me probleme në nivel të ulët dhe të qëndrueshëm dhe është rreth 2,8%. Prandaj, ruajtja e normës më të lartë të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit nuk do të paraqiste pengesë për asnjë nga bankat, veçanërisht pasi në pajtueshmëri me rregulloren, me zbatimin e normës së rritur do të fillojë 12 muaj pas miratimit të tij, gjë që u lë mjaftueshëm hapësirë bankave për të planifikuar pozicionet e tyre kapitale.

Në rast të realizimit të konsiderueshëm të rreziqeve në bilancet e bankave, duke marrë parasysh natyrën e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit dhe udhëzimet e institucioneve përkatëse europiane, **Banka Popullore mund të vlerësojë edhe nevojën për lirim të pjesshëm ose të plotë të tij,** si mbështetje për operacionet e bankave në çdo skenar të pafavorshëm.

Pritet që si deri tani, bankat të vazhdojnë të planifikojnë me kujdes nevojat e tyre kapitale dhe do t'i japin përparësi ruajtjes dhe forcimit të mëtejshëm të pozicioneve të kapitalit, në pajtueshmëri me rreziqet e ndërmarra në punë. Banka Popullore do të vazhdojë të mbikëqyr nga afër si deri më tani rreziqet sistematike dhe do të rivlerësojë nivelin e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit në baza të rregullta tremujore.